

VENDIM
Nr.105, datë 3.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS GOLAJ TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Golaj të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Golaj të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.338, datë 20.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Golaj të qarkut të Kukësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Golaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Golaj

Lidhje 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
5-25	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
26-41	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
115-118	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
49-114	Varrezat publike	Në përdorim
388-399(Vetëm trojet)	Infrastrukturë (Troje të lira)	Në pronësi
301-386,388-399 (Vetëm sheshet dhe sip.e gjelbërta)	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike.)	Në pronësi
191	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
120-137,139-183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
184-190	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
402,404-413,415-421	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
403,414,422,476-481,484-493	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi
204-221	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-	Në pronësi

	kanalizimeve.	
222	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi